



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:179987

Datë: 28.01.2020

Numri i dokumentit: 00790686

P. nr. 103/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Fatbardha Uka Ibrahim, në çështjen penale kundër të pandehurëve B. K. dhe F. G. të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore nga Prishtina, PP.II.nr.6661/18 të datës 15.01.2019, për shkak se veç e veç kanë kryer veprën penale Sulmi nga nenin 187 par 1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën Prokurorisë Themelore në Prishtinë për dhënien e urdhrit ndëshkimor: dënim me gjobë, me datë 20.01.2020, mori:

A K T G J Y K I M

Pranohet Kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II.nr. 6661/18, të dt. 15.01.2019, gjykata jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Të pandehurit

B. K. nga i ati I. dhe e ëma T., e gjinisë G., i lindur me në Prishtinë, me vendbanim në Rr. “.....”, pn Prishtinë, me gjendje të mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

Fisnik Gashi nga i ati Z. dhe e ëma M., e gjinisë S., i lindur më në fsh. M., Komuna e P. ku dhe jeton, ka të kryer shkollën fillore, gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

JANË FAJTOR

Për shkak se:

Me datë 20.04.2018 rreth orës 09:40, në Rr. “.....”, në Prishtinë, gjendet afër shkollës së Mesme “.....”, përball lokalit “D.”, të pandehurit B. K. dhe F. G. pas një mosmarrëveshje të

atëçastshme, pas një mosmarrëveshje të çastit dhe me dashje kanë përdorur forcën duke goditur njëri tjetrin me grusht në fytyrë dhe në trup

-me këtë të pandehurit secili veç e veç kanë kryer veprën penale Sulm nga neni 187 par 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform neneve 7, 17, 21, 31, 41, 43, 46, 187 të KPRK, si dhe neneve 365 dhe 495 të KPPRK-së, shqipton këtë:

DËNIM ME GJOBË

I pandehuri **B.K.** dënohet e gjobë në shumë prej **150.00 € (njëqindë e pesëdhjetë euro)** të cilën mund të paguaj në dy këste mujore në afatin ligjor nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

I pandehuri **F. G.** dënohet e gjobë në shumë prej **150.00 € (njëqindë e pesëdhjetë euro)** të cilën mund të paguaj në dy këste mujore në afatin ligjor nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga një ditë burg për 20 € të gjobës.

Obligohen të pandehurit secili veç e veç të paguajnë paushallin në shumë prej 20 € nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.66661/18 të dt. 15.01.2019 ka akuzuar B. K. dhe F. G. për veprën penale Sulm nga neni 187 par 1 të KPRK-së, me kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor e arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga të pandehurit.

Gjyqtarja e çështjes me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493 të KPPK, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPK, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimorë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, kallëzimit penal të datës me nr. 2018-AB-0512 të datës 29.10.2018, deklaratat e të pandehurëve B. K. dhe F. G. të datës 20.04.2018, janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se të pandehurit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës në emër të paushallit gjyqësor u mor konform nenit 450 të KPPK.

Vendimin për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest juridiko – civil, gjykata e mori në bazë të nenit 463 par. 2, të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë në bazë të neneve 365 dhe 495 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
P.nr.103/19, të dt. 20.01.2020

G j y q t a r j a
Fatbardha Uka Ibrahim

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimet të tij, në këtë gjykatë.